LIGJ
Nr. 26/2016

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN, I CILI AMENDON KONVENTËN E DATËS 12 NËNTOR 1999, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS ZVICERANE PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË, LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran, i cili amendon konventën e datës 12 nëntor 1999, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për shmangien e taksimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2016

Shpallur me dekretin nr. 9478, datë 24.3.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

PROTOKOLL
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT FEDERAL ZVICERAN, I CILI AMENDON KONVENTËN E DATËS 12 NËNTOR 1999, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS ZVICERANE PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË NË LIDHJE ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli Federal Zviceran,

me dëshirën për të lidhur një protokoll për amendimin e Konventës, të datës 12 nëntor 1999, ndërmjet Konfederatës Zvicerane dhe Republikës së Shqipërisë, për shmangien e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin (në vijim e referuar si "Konventa"),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Nënparagrafi "a", i paragrafit 3, të nenit 2 (Tatimet e përfshira) i Konventës, zëvendësohet me

nënparagrafin e mëposhtëm:

"a) në Shqipëri:

i) tatimet mbi të ardhurat, duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e të ardhurave nga kapitali ose nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;

ii) tatimi i aktiviteteve të biznesit të vogël; dhe

iii) tatimi mbi pasurinë;

(i referuar në vijim si "Tatimi shqiptar");".

Neni 2

Nënparagrafi "b", i paragrafit 1, të nenit 3 (Përkufizime të përgjithshme) i Konventës, zëvendësohet nga nënparagrafi i mëposhtëm:

"b) Termi "Zvicër" nënkupton territorin e Konfederatës Zvicerane, siç përcaktohet nga ligjet e saj në përputhje me të drejtën ndërkombëtare".

Neni 3

Klauzola "ii", e nënparagrafit "h", të paragrafit 1, të nenit 3 (Përkufizime të përgjithshme) të Konventës, zëvendësohet nga klauzola e mëposhtme:

"ii) në rastin e Zvicrës, drejtuesi i Departamentit Federal të Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar".

Neni 4

Paragrafi 1, i nenit 4 (Rezidenti) i Konventës fshihet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

"1. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "rezident i një Shteti Kontraktues" nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekt i tatimeve të atij shteti për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të menaxhimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe, gjithashtu, përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritet vendor të tij. Ky term, megjithatë, nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë shtet vetëm për sa i përket të ardhurave nga burime në atë Shtet apo kapitalit të vendosur aty.".

Neni 5

1. Paragrafët ekzistues 3 deri 6, të nenit 11 (Interesi) të Konventës rinumërohen si paragrafët 4 deri 7.

2. Paragrafi 3 në vijim i shtohet nenit 11 (Interesi) të Konventës.

"3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 2, interesat e krijuara në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, i cili është pronari i tyre përfitues, do të tatohen vetëm në atë Shtet tjetër në masën që ky interes paguhet

a) për një skemë pensioni; ose

b) për qeverinë e atij Shteti tjetër, një nënndarje politike apo autoritet vendor të tij ose në bankën qendrore të Shtetit tjetër.".

3. Paragrafi i rinumëruar 6, i nenit 11 (Interesi) i Konventës, fshihet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

"6. Interesat konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, në rastet kur personi që paguan interesat, qoftë rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi (borxhi) për të cilin paguhet interesi dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.".

Neni 6

Paragrafi 5 i nenit 12 (Të drejtat e patentave, licencave etj.) të Konventës, fshihet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

"5. Të drejtat e patentave, licencave etj., konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është një rezident i atij Shteti. Megjithatë, në rastet kur personi që paguan të drejtat e patentave, licencave etj., qoftë rezident i një Shteti Kontraktues apo jo, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur detyrimi për pagesën e të drejtave të patentave, licencave etj., dhe të drejta të tilla të patentave, licencave etj., krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto të drejta të patentave, licencave etj., do të konsiderohen se janë krijuar në Shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose baza fikse.".

Neni 7

Paragrafi 3, i nenit 24 (Mosdiskriminimi) i Konventës, fshihet dhe zëvendësohet me paragrafin e mëposhtëm:

"3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e nenit 9, paragrafit 7, të nenit 11 ose paragrafit 6, të nenit 12, interesat, të drejtat e patentave, licencave etj., dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues për një rezident të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme nën të njëjtat kushte sikur t'i paguheshin një rezidenti të Shtetit të përmendur fillimisht.

Në mënyrë të ngjashme, borxhet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për qëllim të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme nën të njëjtat kushte sikur t'i ishin kontraktuar një rezident i Shtetit të përmendur fillimisht.

Neni 8

Paragrafët e mëposhtëm 5 dhe 6, i shtohen nenit 25 (Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë) të Konventës:

"5. Ku:

a) sipas paragrafit 1, një person ka paraqitur një çështje për autoritetin kompetent të një Shteti Kontraktues mbi bazën se veprimet e njërit apo të të dyja Shteteve Kontraktuese kanë rezultuar për atë person në taksimin e tij jo në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente; dhe

b) autoritetet kompetente nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje për të zgjidhur këtë çështje në pajtim me paragrafin 2 brenda tri viteve nga paraqitja e çështjes tek autoriteti kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues,

çështjet e pazgjidhura, që rrjedhin nga rasti, do të dorëzohen në arbitrazh sipas kërkesës së personit. Me përjashtim të rastit kur një person i cenuar drejtpërdrejt nga çështja nuk e pranon marrëveshjen e ndërsjellë që zbaton vendimin e arbitrazhit ose autoriteteve kompetente dhe personat e cenuar drejtpërdrejt nga çështja, bien dakord për një zgjidhje të ndryshme, brenda gjashtë muajve pasi vendimi i është komunikuar atyre, vendimi i arbitrazhit do të jetë detyrues për të dyja shtetet dhe do të zbatohet pavarësisht nga afatet kohore të ligjeve të brendshme të këtyre shteteve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, vendosin me mirëkuptim reciprok, mënyrën e zbatimit të këtij paragrafi.

6. Shtetet kontraktuese mund të japin për bordin e arbitrazhit të krijuar sipas dispozitave të paragrafit 5, një informacion të tillë, në masën që është e nevojshme për zbatimin e procedurës së arbitrazhit. Anëtarët e bordit të arbitrazhit u nënshtrohen kufizimeve të zbulimit të informacionit të përshkruara në paragrafin 2, të nenit 26, në lidhje me informacionin e nxjerrë në këtë mënyrë".

Neni 9

Nenet ekzistuese 26, 27 dhe 28 të Konventës, rinumërohen si nenet 27, 28 dhe 29.

Neni 10

Neni 26 në vijim (Shkëmbimi i informacionit) shtohet në Konventë:

"Neni 26
Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese shkëmbejnë informacionet, siç parashikohen të jenë të nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose për administrimin, zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e vendosur në emër të Shteteve Kontraktuese, nënndarjeve të tyre politike apo autoriteteve vendore, në masën që ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Informacionet e marra sipas paragrafit 1 nga një Shtet Kontraktues, trajtohen sekrete në të njëjtën mënyrë si informacionet e marra nën ligjet e brendshme të atij Shteti dhe i zbulohen vetëm personave apo autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative), që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin apo ndjekjen ligjore të tyre në lidhje me përcaktimin e ankesave për tatimet e përmendura në paragrafin 1 ose me mbikëqyrjen e sa më sipër. Këta persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta ofrojnë informacionin në procedurat gjyqësore publike apo vendimet gjyqësore. Pavarësisht nga sa më sipër, informacioni i marrë nga një Shtet Kontraktues mund të përdoret për qëllime të tjera kur ky informacion mund të përdoret për qëllime të tilla të tjera sipas ligjeve të të dyja shteteve dhe të autoritetit kompetent të Shtetit që e autorizon këtë përdorim.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, nuk do të interpretohen sikur vendosin te një Shtet Kontraktues detyrimin, për:

a) zbatimin e masave administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikat adminis-trative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontrak-tues;

b) dhënien e informacioneve të cilat nuk mund të merren sipas ligjeve apo praktikës normale administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) dhënien e informacioneve të cilat mund të zbulonin një sekret tregtar, biznesi, sekret industrial, tregtar ose profesional ose proces tregtar apo informacione, zbulimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një Shtet Kontraktues, në pajtim me këtë nen, Shteti tjetër Kontraktues do të ndërmarrë masat e tij të mbledhjes së informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, edhe pse këtij Shteti tjetër mund të mos i nevojitet një informacion i tillë për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi që përmban fjalia e mësipërme i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk do të interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të mos japë më informacion vetëm për shkak se ai nuk ka interesa të brendshme në këtë informacion.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk interpretohen se lejojnë një Shtet Kontraktues të mos japë informacion vetëm për shkak se informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar i caktuar ose person që vepron në një agjenci ose në një cilësi fiduciare ose për shkak se ai lidhet me interesa pronësore të një personi.".

Neni 11

1. Paragrafi ekzistues 4 i Protokollit të Konventës rinumërohet si paragrafi 6.

2. Paragrafi i ri 4 në vijim shtohet në Protokollin e Konventës:

"4. Nenet 10, 11, 12 dhe 21:

a) Dispozitat e neneve 10, 11, 12 dhe 21 nuk zbatohen për zërin e të ardhurave të paguara sipas një transaksioni, një pjese të një transaksioni ose një serie të transaksioneve, ose që rrjedh nga një njësi ekonomike, nëse qëllimi kryesor i përfundimit apo krijimit të tij është marrja e përfitimeve sipas neneve 10, 11, 12 dhe 21, dhe nëse - duke lënë mënjanë transaksionin, pjesën e transaksionit, serinë e transaksioneve ose njësinë ekonomike - zëri i të ardhurave është caktuar

për një person që nuk është rezident i ndonjërit prej Shteteve Kontraktuese;

b) Dispozitat e nënparagrafit "a", të paragrafit 2, të nenit 10, nuk zbatohen për dividentët e paguar sipas një transaksioni, një pjesë të një transaksioni ose serie të transaksioneve, ose që rrjedhin nga një njësi ekonomike, nëse qëllimi kryesor i përfundimit apo krijimit të tyre është marrja e përfitimeve të nënparagrafit "a", të paragrafit 2, të nenit 10, dhe nëse - duke lënë mënjanë transaksionin, pjesën e transaksionit, serinë e transaksioneve ose njësinë ekonomike - ata dividendë janë caktuar për një person i cili nuk i plotëson kushtet e nënparagrafit "a", të paragrafit 2, të nenit 10, në lidhje me ata dividendë;

c) Nëse - duke lënë mënjanë transaksionin, pjesën e transaksionit, serinë e transaksioneve apo njësinë ekonomike - zëri i të ardhurave është caktuar për një person i cili, sipas konventës për shmangien e taksimit të dyfishtë ndërmjet Shtetit në të cilin personi është rezident (banor) dhe Shtetit në të cilin lindin të ardhurat apo sipas një marrëveshjeje tjetër, do të ketë të drejtë për përfitime në lidhje me atë zë të të ardhurave ekuivalente ose më të favorshme se ato të disponueshme në bazë të kësaj Konvente për një rezident të një Shteti Kontraktues, qëllimi kryesor i transaksionit, i pjesës së transaksionit, serisë së transaksioneve ose i njësisë ekonomike nuk do të konsiderohet të jetë marrja e përfitimeve sipas neneve 10, 11, 12 dhe 21.

Neni 12

Paragrafi 5 në vijim shtohet në Protokollin e Konventës:

"5. Neni 11

Është e kuptueshme se termi "skema e pensioneve", siç përdoret në këtë nen, nënkupton çdo plan, skemë, fond, fondacion, trust ose masë tjetër të krijuar në një Shtet Kontraktues, i cili rregullohet nga dhe përgjithësisht përjashtohet nga tatimi mbi të ardhurat në atë Shtet dhe që funksionon kryesisht për të administruar ose siguruar përfitimet e pensioneve apo të daljes në pension ose për përfitimin e të ardhurave në interes të një ose më shumë skemave të tilla dhe përfshin sa më poshtë:

a) në Shqipëri, çdo skemë pensioni të mbuluar nga:

i) ligji nr. 10197, i datës 10.12.2009, "Për fondet e pensioneve vullnetare";

ii) ligji nr. 7703, i datës 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë";

iii) ligji nr. 10142, i datës 15.5.2009, "Për sigurimet suplementare shoqërore për Forcat Ushtarake të Armatosura, punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës Kombëtare, Shërbimit të Inteligjencës, Policisë së Burgjeve, Policisë së Zjarrit, Policisë së Shpëtimit dhe i Shërbimeve të Auditimit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë";

iv) ligji nr. 8097, i datës 21.3.1996, "Për pensionet suplementare shtetërore për personat që kryenin funksione kushtetuese dhe punonjësit shtetërorë";

v) ligji nr. 10139, i datës 15.5.2009, "Për pensionet suplementare shtetërore të punonjësve të universiteteve, institucioneve të arsimit të lartë, Qendrës për Studime Shqiptare, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj akademikë";

vi) ligji nr. 150/2014, "Për pensionet e minatorëve";

b) në Zvicër, të gjitha skemat e pensionit të mbuluara nga:

i) Akti Federal mbi sigurimin e pleqërisë dhe sigurimin e pasardhësve, i datës 20 dhjetor 1946;

ii) Akti Federal mbi sigurimin e personave me aftësi të kufizuara, i datës 19 qershor 1959;

iii) Akti Federal mbi pensionet suplementare në lidhje me sigurimin e pleqërisë, të pasardhësve dhe personat me aftësi të kufizuara, i datës 6 tetor 2006;

iv) Akti Federal mbi sigurimin e pleqërisë, sigurimin e pasardhësve dhe personave me aftësi të kufizuara, i pagueshëm për sa i përket punësimit ose vetëpunësimit, të datës 25 qershor 1982, duke përfshirë skemat e paregjistruara të pensioneve, të cilat ofrojnë planet e pensioneve profesionale; dhe

v) format e skemave individuale pensionale të njohura, të krahasueshme me planet e

pensioneve profesionale, në përputhje me nenin 82 të Aktit Federal, mbi sigurimin e pleqërisë, të pasardhësve dhe personave me aftësi të kufizuara, të pagueshme për sa i përket punësimit ose vetëpunësimit, të datës 25 qershor 1982;

c) dhe çdo skemë identike ose të ngjashme të vendosur sipas legjislacionit të paraqitur pas datës së nënshkrimit të këtij Protokolli, siç është rënë dakord ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Kontraktuese.".

Neni 13

Paragrafi 7 në vijim i shtohet Protokollit të Konventës:

"7. Neni 12

Duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 12, nëse Republika e Shqipërisë lidh një Marrëveshje të çdo lloji dhe natyre apo një Marrëveshje të Tatimit të Dyfishtë, me një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, duke siguruar norma tatimore, më të ulëta se 5 për qind, siç parashikohet në këtë nen 12, kjo normë më e ulët do të jetë automatikisht e zbatueshme në këtë Konventë sapo ajo të hyjë në fuqi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe këtij shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose Zonës Ekonomike Evropiane.

Neni 14

Paragrafi 8 në vijim i shtohet Protokollit të Konventës:

"8. Neni 26

a) Është e kuptueshme që shkëmbimi i informacionit kërkohet vetëm pasi Shteti kërkues Kontraktues t'i ketë shteruar të gjitha burimet e rregullta të informacionit, të disponueshme sipas regjimit të brendshëm tatimor.

b) Është e kuptueshme që autoritetet tatimore të Shtetit kërkues do të sigurojnë informacionin e mëposhtëm për autoritetet tatimore të Shtetit të kërkuar, në kërkesat për informacione sipas nenit 26:

i) identiteti i personit nën procesin e marrjes në pyetje apo hetim;

ii) periudha e kohës për të cilën është kërkuar informacion;

iii) një deklaratë mbi informacionin e kërkuar, duke përfshirë natyrën e saj dhe formën në të cilën Shteti kërkues dëshiron të marrë informacion nga Shteti i kërkuar;

iv) qëllimin tatimor për të cilin kërkohet informacioni;

v) në masën e njohur, emrin dhe adresën e çdo personi që besohet të jetë në zotërim të informacionit të kërkuar.

c) Është e kuptueshme se referenca për "rëndësinë e parashikueshme", ka për qëllim të sigurojë shkëmbimin e informacionit në çështjet tatimore deri në masën e gjerë të mundshme dhe, në të njëjtën kohë, të sqarojë se Shtetet Kontraktuese nuk janë të lira për t'u angazhuar në "ekspedita të peshkimit" ose të kërkojnë informacione, që nuk mund të jenë të rëndësishme për çështjet tatimore të tatimpaguesit të caktuar. Ndërsa nënparagrafi "b" përmban kërkesat e rëndësishme procedurale, të cilat synojnë të sigurojnë që nuk do të ndodhin "ekspedita të peshkimit", klauzolat "i" deri "v", të nënparagrafit "b", megjithatë, nuk duhet të interpretohen në një mënyrë që pengon shkëmbimin efektiv të informacionit.

d) Është e kuptueshme se neni 26 nuk kërkon që Shtetet Kontraktuese të shkëmbejnë informacion mbi baza automatike apo spontane.

e) Është e kuptueshme se në rast të një shkëmbimi të informacionit, rregullat procedurale administrative të lidhura me të drejtat e tatimpaguesve, të parashikuara në Shtetin e kërkuar Kontraktues mbeten të zbatueshme. Kuptohet më tej, se këto dispozita synojnë garantimin për tatimpaguesin të një procedure të drejtë dhe jo parandalimin ose vonimin padrejtësisht të procesit të shkëmbimit të informacionit.".

Neni 15

1. Secili Shtet Kontraktues do të njoftojë tjetrin, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të kërkuara nga ligji i tij për hyrjen në fuqi të këtij Protokolli. Protokolli do të hyjë në fuqi në datën më të vonë të marrjes së këtyre njoftimeve.

2. Dispozitat e Protokollit do të kenë efekt:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim mbi shumat e paguara ose të kredituara më ose pas ditës së parë të muajit janar të vitit kalendarik të ardhshëm pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli;

b) në lidhje me tatimet e tjera për vitet tatimore që fillojnë më ose pas ditës së parë të muajit janar të vitit kalendarik të ardhshëm pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli;

c) në lidhje me nenin 25, paragrafët 5 dhe 6, për procedurat e mirëkuptimit të ndërsjellë, të cilat janë:

i) të mbetura pezull ndërmjet autoriteteve kompetente të Shteteve Kontraktuese me hyrjen në fuqi të Protokollit (në raste të tilla, periudha trevjeçare, sipas nënparagrafit "b" fillon me hyrjen në fuqi të këtij Protokolli); ose

ii) iniciuar pas asaj date;

d) në lidhje me nenin 26, ndaj informacionit që lidhet me vitet fiskale, të cilat fillojnë më ose pas ditës së parë të muajit janar të vitit kalendarik të ardhshëm pas hyrjes në fuqi të këtij Protokolli.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në dy kopje, në Tiranë, më 9 shtator 2015, në gjuhën shqipe, frënge dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim ndërmjet tekstit në gjuhën frënge dhe shqipe, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.